



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 298, datë 18.12.2019

PËR
CAKTIMIN NË POZICION, NË MËNYRË TË PËRKOOSHME, NË GJYKATËN E
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR TË GJYQTARES ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 162, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR